Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
vigan syla	**26.12.2023**	**07.01.2024**	**2023/1040**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.12.2023, OE "PRO MEDICAL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1040, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Blerja e paisjeve mjekesore per QKMF-ne" me nr. të prokurimit: "617-23-11005-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, , , lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: xx,xxx €. Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0941 i dt:12.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1 – Qellimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
Neni 7 – Barazia ne trajtim / jo diskriminimi
Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

"Ju njoftojm se kemi anuluar aktivitetin e prokurimit per Blerjen e paisjeve mjekesore per QKMF-ne, per asyje se jemi ne fund te vitit fiskal, dhe eshte e pa mundur arritja e afateve kohore per neneshkrim te kontrates dhe realizimin e saj kete vit.
Mjetet e parpara per kete projekt jane nga grandi qeveritar, dhe nuk barten ne vitin tjeter, keshtu qe ne si AK nuk mund te hym ne mardhenje kontraktuale pa pasur mjete financiare."

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0941

Paneli Shqyrtues, duke vendosur në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) lidhur me ankesën e OE "PRO MEDICAL" SH.P.K., ushtruar kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF-në" me numër të prokurimit 617-23-11005-1-2-1, iniciuar nga "KOMUNA SHTIME" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), më 12/12/2023, mori:

Vendim

1. **Përfundon** procedura e shqyrtimit në këtë çështje administrative, për shkak të pajtimit të arritur mes palëve, "KOMUNA SHTIME" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik OE "PRO MEDICAL" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF-në", me numër të prokurimit 617-23-11005-1-2-1.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar. të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PRO MEDICAL SH.P.K.**

Hyrje

Ky është ankesa e dytë lidhur me ketë aktivitet të prokurimit. Në herën e parë, AK na ka eliminuar nga ky proces në kundërshtim me Ligjin për Prokurimet Publike (LPP). Pas Ankeses në OSHP, ju lutemi të shikoni Vendimin me numër Prokurimi # 0941, ku ky aktivitet i prokurimit është rikthyer në rivlersim. Si AK dhe OE jemi pajtuar me raportin e ekspertit në atë kohë, por AK kësaj herë anulon aktivitetin e prokurimit ne kundershtim me LPP Neni 62 dhe nga neglizhenca e AK, ku ne si OE penalizohemi per veprimet e AK.

Neni 1- Qëllimi -E kundershtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njejti eshte ne kundershti me nenin 1 te Ligjit per Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin.
AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim "***Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji***"

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ne Pro Medical nuk jemi trajtuar si të barabartë nga AK dhe në kundërshtim me LPP dhe RrPP sepse AK nuk e ka respektuar LPP ku anulimi i keti aktiviteti te prokurimit bie ndesh me LPP, gjithashtu edhe eliminim jone heren e para ka qene ne kundershtim me LPP edhe pse kjo është konfirmuar nga OSHP, edhe kësaj here na mohon të drejtën që shperblemi me kontratë konfrom LPP.

AK ka marr Vendim per anulimin e aktivitetit te prokurimit me arsytim të pa bazuar në LPP Neni 62 pasi që një që tillë nuk është e rregulluar me LPP në fuqi dhe nje arystim i till AK bie ndesh me LPP Neni 62 edhe nje herit AK duke përdoror këtë praktike ne nje menyre bie deri ne abuzim me LPP, ku rrejshimish AK nuk do respektuar edhe Neni 7.
Pasi që neni 62 i LPP mjaftë qartë precizon se në cilat raste mund të përfundoj aktiviteti i prokurimit, po ashtu edhe në nenin 43 të RRPP 001/2022 përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, ndërsa, arsyeshmëria e AK për ndërprerje të kësaj procedure nuk parashihet në këtë dispozitë. Sepse AK është i obliguar të që konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim.

Andaj AK duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur bazë ligjore pra në kundërshtim me LPP sidomos Neni 62 dhe AK duke mos marr asnje mundim që të përfundoj këtë aktivitet të prokurimit konfrom LPP dhe arsytimi i cekur në njoftimi e AK me datën 15.12.2023 për anulim me eshte një arsytim jo valid dhe pa bazë ligjore.

Me rastin e anulimit te aktivitetet të prokurimit AK nuk ka respektuar asnjë nga depozitat e nenit 62 te LPP-së, madje edhe ne interpretimin KRPP- është sqaruar se ne cilat rrethana AK mund te anuloj aktivitetin e prokurimit.
Gjithashtu edhe RrPP Pika 43. Ndërprerja e procedurave të prokurimit -Pra shum qart RrPP pikat e cekur ne paragrafin 43.5 shpreh pra qart lidhur se kur mund AK te anuloj nje aktivitet të prokurimit pra arsyetimi AK në këtë rast pra në vendimin tuaj bie ndesh edhe LPP edhe me RrPP Pika 43.5 kurse Rrregullore për prokurimin publik 2022 qart e specifikon kur nje tender mund te anulohet pas hapjes.

Sipas spjegimeve te paraqitura konstatojme qe kjo ankese e perseritur eshte gjykuar njehere me vendimin e marre nga PSH te cilet konstatojne se perfundon kjo procedure ankimore ngase te gjitha palet jane pajtuar me gjetjet e ekspertit si dhe lenda eshte kthyer ne rivleresim. Por pas kesaj AK ka derguar nje njoftim ku spjegon se ka anuluar proceduren mbi arsyetimin se:

"Ju njoftojm se kemi anuluar aktivitetin e prokurimit per Blerjen e paisjeve mjekesore per QKMF-ne, per asyje se jemi ne fund te vitit fiskal, dhe eshte e pa mundur arritja e afateve kohore per neneshkrim te kontrates dhe realizimin e saj kete vit.
Mjetet e parpara per kete projekt jane nga grandi qeveritar, dhe nuk barten ne vitin tjeter, keshtu qe ne si AK nuk mund te hym ne mardhenje kontraktuale pa pasur mjete financiare."

me kete rast duke mos respektuar paragrafin ne vendimin e PSH i cili thote qe:

Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të nenit 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP parashihet se, cituar: "Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë. Për më tepër informohen palët, që ky vendim ka karakter procedural për palët në procedurë dhe në rrethana të tilla të gjeturat e këtij raporti nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Paneli Shqyrtues .

Ne baze te kesaj pergjigje dhe sqarimi te dhene nga AK, eksperti ka derguar kerkese me shkrim nepermjet emailit drejtuar AK Komuna Shtime me çrast ka kerkuar nga ta te dergojne Buxhetin e planifikuar per vitin 2024 ku edhe ka marre te bashkengjitur kete dokument ne te cilin shihet qe ne tabelen me kodin 53578 figuron pozicioni ne vlere prej 30,000.00 me titull: "Blerja e Pajisjeve mjekesore per QKMF-ne". Pas kesaj eksperti edhe njehere ka kerkuar permes emailin qe autoriteti kontratues ta rikonfirmoje se ekziston disponueshmeria e ketyre mjeteve per shfrytezim per kete projekt ne vitin 2024. Pergjigja e autoritet ishte si me poshte:

PS Prokurimi Shtime <prokurimi.shtime@gmail.com>
To: You

Përshëndetje,

Ne si AK, dhe derguar buxhetin 2023-2024, për aktivitetin e cekur, nuk ka mjete te planifikuar dhe për këtë arsye nuk kemi vazhdu procedura dhe nenshkrua

On Fri, Jan 12, 2024 at 10:40 AM Vigan Syla <vigan_syla@hotmail.com> wrote:

E nderuara Znj. Feride,

Ju faleminderit për dërgimin e informacionit të kërkurar.

Në menyrë të sqarimit sa më adekuat të çështjes në fjalë, më mirësi kërkoj nga ju që të më njoftoni lidhur me disponueshmerinë e mjeteve për vitin 2024 pë

Në bazë të dokumentit që e keni dërguar, shifet se këto mjete (kodi 5357) ekzistojnë në bugjetin e vitit 2024.

Ju faleminderit paraprakisht.

Me respekt:
Vigan Syla

Ne anen tjeter, ne tabelat e derguara edhe pse jane te pakjarta per shkak te skanimit eksperti nuk ka mund te verifikoje nese kjo pergjigje eshte e sakte ne baze te dokumentacionit te ofruar ngase ne tabelen e derguar per vitin 2023 nuk ka shenime qe tregojne qe ajo tabele eshte e atij viti, andaj eksperti eshte i mendimit qe nese Autoriteti konsideron dhe insiston qe keto mjete jane terhekur atehere le te mbetet ne diskrecionin e Panelit Shqyrtues te vendos per anulimin ose jo te ketij aktiviteti.

				Totali (GQ) - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni		155,977	769,174	391,167	1,160,341	865,404
				Totali (Te Hyrat Vetanake) - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni		0	0	246,856	246,856	378,000
				Totali - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni		155,977	769,174	638,023	1,407,197	1,243,404
				Totali (GQ) - Planifikimi Urban dhe Mjedisi		155,977	769,174	391,167	1,160,341	865,404
				Totali (Te Hyrat Vetanake) - Planifikimi Urban dhe Mjedisi		0	0	246,856	246,856	378,000
				Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi		155,977	769,174	638,023	1,407,197	1,243,404
	617730 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale									
	734500 - Shërbimet e shëndetësisë primare									
0721	617730-2343115	53571	03.2023-08.2025	Renovimi i objekteve shëndetësore (QKMF ne Shtime dhe QMF-te ne Pjetershtic, Petrove, Godanc dhe Muzeqine)	GQ	0	0	65,000	65,000	130,000
0721	617730-2343127	53578	03.2023-11.2025	Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF-në	GQ	0	0	30,000	30,000	250,000
0721	617730-2343207	53639	03.2023-7.2023	Blerja e veturës për QKMF-në për vizita në teren	GQ	0	0	20,000	20,000	0
				Totali (GQ) - Shërbimet e shëndetësisë primare		0	0	115,000	115,000	280,000
				Totali - Shërbimet e shëndetësisë primare		0	0	115,000	115,000	280,000
				Totali (GQ) - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale		0	0	115,000	115,000	280,000

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Ministarstvo za Financija, Rad i Transfere | Ministry of Finance, Labor and Transfers

Buxheti i Kosovës për vitin 2024

Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale

anizata Buxhetore - Programi - Nën-Programi							Aprovuar per vitin 2024			V
i k	Kodi i Prop	Kodi Proj	Data e Fillimit dhe Mbarimit	Emri i Projektit	Burimet E Fin.	Shpenz deri më 2023	Vazhdim nga 2023	Të reja për 2024	Totali 2024	Vitin 2025
						1	2	3	4=2+3	5
0	617730-2445621		05.2024-07.2024	Blerja dhe instalimi i pompes termike ne QKMF-ne	GQ	0	0	25,000	25,000	0
1	617730-2445629		04.2024-06.2024	Rrobalarse industriale per QKMF	GQ	0	0	5,000	5,000	0
				Totali(GQ) - Shërbimet e shëndetësisë primare		0	0	100,000	100,000	114,882
				Totali - Shërbimet e shëndetësisë primare		0	0	100,000	100,000	114,882
				Totali (GQ) - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale		0	0	100,000	100,000	114,882
				Totali - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale		0	0	100,000	100,000	114,882
617755 - Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale										
617730 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale										
734500 - Shërbimet e shëndetësisë primare										
0	617730-2445608		03.2024-10.2026	Renovimi i objekteve shendetsore, oborreve dhe digjitalizimi QKMF-se Shtime QMF Pjetershtice, Godanc, Petrove, Muzeqine	GQ	0	0	25,000	25,000	
0	617730-2445614		04.2024-07.2024	Blerja e Autoambulances per QKMF-ne (me paisje speciale)	GQ	0	0	45,000	45,000	

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti është i mendimit që nëse Autoriteti konsideron dhe insiston që këto mjete janë tërhekur atëherë le të mbetet në diskrecionin e Panelit Shqyrtues të vendos për anulimin ose jo të këtij aktiviteti.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PRO MEDICAL SH.P.K.**

vigan syla

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA